



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr. 2395, datë 05. 12. 2013**

**Për**

**“Miratimin e dokumentit “Rregullore për Autorizimin Individual””.**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1.	Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2.	Z. Alban	Karapici	Anëtar
3.	Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4.	Z. Benon	Paloka	Anëtar
5.	Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Elda Topi, në mbledhjen e datës 05.12. 2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Per miratimin e dokumentit “Rregullore për Autorizimin Individual””.**

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 127, 128 i Ligjit Nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”.
2. Germa p) të nenit 8, neni 62 e vijues të ligjit 9918 datë 19.05.2008 “*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*” (**ligji nr. 9918 i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”**”);.
3. Rregullore për Autorizimin Individual (**Rregullorja**), miratuar me VKD nr. 510 datë 04. 11. 2008;
4. Urdhër i Kryetarit Nr. 571, datë 24.05.2010, i ndryshuar.

## KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor te grupit te punes si me poshte:

1. Relacioni shpjegues “Për Miratimin e dokumentit “Rregullore për Autorizimin Individual”.
2. Projekt aktet e paraqitura për miratim:
  1. Rregullore për Autorizimin Individual
    - 1.1 Formularët e aplikimit për caktim frekuencash, Aneksi 2- Aneksi 8.
    - 1.2 Formular Ankimi për Interferencat Radio.
    - 1.3 Formatit i faqes se pare te Autorizimit Individual.
    - 1.4 Formatet e Autorizimit Individual me te cilin do te pajisen sipërmarrësit, Aneks 1, Aneksi 2-1 – Aneksin 8-1.
  - Raporti perfundimtar mbi proceduren e zhvilluar te keshillimit publik dhe perfundimet e tij;
  - Mendimet formale te paleve te interesuara te depozituara me shkrim ne AKEP;
  - Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar;
  - Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

1. Propozimin e mbeshtetur te grupit te punes, bazuar ne parimet e eficences dhe transparences ne administraten publike,
2. qellimin funksional te procedures se parashikuar dhe rregullave te saj si dhe
3. standartin e thjeshtezuar te aplikimeve te ndryshme per ofrim te rrjeteve dhe sherbimeve te komunikimeve elektronike, si dhe
4. perdorimin e burimeve natyrore te kufizuara.

## P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë:

1. Nenin 127, 128 i Ligjit Nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”.
2. Germa p) të nenit 8, neni 62 e vijues të ligjit 9918 datë 19.05.2008 “*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*” (**ligji nr. 9918 i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”**”);.
3. Rregullore për Autorizimin Individual (**Rregullorja**), miratuar me VKD nr. 510 datë 04. 11. 2008;
4. Urdhër i Kryetarit Nr. 571, datë 24.05.2010, i ndryshuar.

## V E N D O S :

1. Të miratojë dokumentin: **Rregullore për “Autorizimin Individual” dhe anekset bashkelidhur:**
  - Formularët e aplikimit për caktim frekuencash, Aneksi 2- Aneksi 8;
  - Formular Ankimi për Interferencat Radio;
  - Formatet e faqes se pare te Autorizimit Individual;
  - Formatet e Autorizimit Individual me te cilin do te pajisen sipërmarrësit, Aneksi 1, Aneksi 2-1 – Aneksin 8-1.
  - Kushtet teknike te perdorimit
2. Sipërmarrësit apo subjektet të cilët janë të pajisur me autorizim individual për përdorimin e frekuencave, duhet të kryejnë hedhjen e të dhënave në modulën e aplikimeve online, brenda 3 muajve nga data e miratimit të këtij vendimi.
3. Për aplikuesit e rinj kjo rregullore aplikohet që nga data e miratimit të këtij vendimi.
4. Ky vendim te publikohet ne faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al)
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

## ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** \_\_\_\_\_
2. **Alketa MUKAVELATI** \_\_\_\_\_
3. **Benon PALOKA** \_\_\_\_\_
4. **Zamira NURÇE** \_\_\_\_\_

# **RREGULLORE**

**Nr.30, datë 05.12.2013**

## **PER DHËNIEN E AUTORIZIMIT INDIVIDUAL PËR PËRDORIMIN E FREKUENCAVE**

Në mbështetje të shkronjave g) dhe p) të nenit 8 dhe nenit 67 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr.9918 i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë””),

### **AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

#### **VENDOSI:**

#### **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1 Objekti**

1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) sipas përcaktimeve të ligjit 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, administron spektrin e frekuencave të caktuar për përdorim për qëllime civile, përveç frekuencave të caktuara për transmetimet radio dhe televizive. Sipërmarrësit apo subjektet (Personat fizikë apo juridikë) mund të përdorin frekuenca vetëm pasi të jenë pajisur paraprakisht, me Autorizim Individual nga AKEP-i, sipas përcaktimeve të ligjit 9918, i ndryshuar dhe kesaj rregulloreje.
2. Kjo Rregullore, përcakton procedurën për dhënien e “Autorizimit Individual” për përdorimin e frekuencave, në rastet kur e drejta e përdorimit të frekuencave nuk është e kufizuar. E drejta e përdorimit të frekuencave kufizohet vetëm në rast se kjo kushtëzohet nga pamjaftueshmëria e frekuencave dhe nga detyrimi për të siguruar përdorimin eficient të tyre.
3. Kur përdorimi i radio frekuencave nuk është subjekt i autorizimit të përgjithshëm, sipas pikës 5 të nenit 65 të ligjit nr.9918, te ndryshuar, apo subjekt i një konkurrimi publik, sipas neneve 68 e 69 të këtij ligji, AKEP-i lëshon autorizime individuale për përdorimin e frekuencave, sipas procedurave të përcaktuara në ligj dhe në kete rregullore për:
  - operatorët radiotelevizive që përdorin frekuenca për Lidhje fikse radio, pike-pike;
  - subjektet private që përdorin frekuenca për sisteme radio private të levizshme (PMR), në brezat UHF/VHF;
  - subjekte private që përdorin frekuenca për stacione satelitore ose sisteme TETRA;
  - sipërmarrës që do të përdorin frekuenca për studim, kërkim, prove dhe eksperimentim.

4. Në rastet e kufizimit, për dhënien në përdorim të frekuencave, AKEP-i përdor përdor procedurën e konkurrimit publik në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9918, i ndryshuar dhe akteve nenligjore në zbatim të tij.
5. Administrimi i spektrit duhet të sigurojë neutralitet të teknologjisë së përdorur për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike në brezat radio frekuencave të përcaktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave për shërbime të disponueshme për publikun.,

## **Neni 2 Përkufizimet**

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Aplikant” është çdo person fizik apo juridik i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, i cili ofron rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike për qëllime publike ose private, që aplikon në AKEP për autorizim individual për përdorimin e frekuencave.
2. “Plani Kombëtar i Frekuencave” (PKF) është dokumenti i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM), që përcakton brezat e frekuencave për shërbime të ndryshme dhe vendos kushtet bazë për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, për përdorimin me efektivitet të spektrit të frekuencave dhe shmangien e interferencave.
3. “Plani Përdorimit të Frekuencave” është dokumenti i hartuar nga AKEP-i, që përcakton nënbrezat për shërbimet e ndryshme të radiokomunikimeve, si dhe përmban parametrat dhe kushtet teknike të përdorimit të frekuencave.
4. “Postë elektronike” është çdo mesazh në formën e tekstit, tingullit apo imazhit, të dërguar nëpërmjet rrjetit publik të komunikimeve, i cili mund të ruhet në rrjet ose në pajisjen fundore të marrësit derisa marrësi ta marrë atë.
5. “Moduli i Aplikimit Online për Autorizim Individual” është modul i bazuar mbi teknologjinë Web që mundëson mbledhjen, analizimin, administrimin dhe ruajtjen e të gjithë aplikimeve online për autorizim individual nga sipërmarrësit.
6. “Regjistri Kombëtar i Frekuencave” është baza e të dhënave e cila përmban, minimumi, të dhënat “baze” të kërkuara për administrimin kombëtar të spektrit dhe notifikimin tek ITU-BR.
7. “Sistemi i Menaxhimit të Spektrit” është një aplikim që përdoret me qëllim menaxhimit në mënyrë sa më efektive dhe eficiente të spektrit të radiofrekuencave, kryesisht për shërbimet radio fikse dhe të levizshme tokësore.

## **Neni 3 Përjashtimet**

1. Për përdorimin e frekuencave të caktuara në PKF, për qëllime të sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes së vendit, nuk do të kërkohet autorizim nga AKEP.
2. Frekuencat që mund të përdoren pa u pajisur me Autorizim Individual përcaktohen nga AKEP me rregullore të veçantë, sipas përcaktimeve të nenit 65 të ligjit nr. 9918, të ndryshuar.

## **KREU II**

## PROCEDURA, KUSHTET DHE VLEFSHMËRIA

### Neni 4 Procedura

1. Dhënia në përdorim e frekuencave nga AKEP-i, bëhet në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave dhe Planit të Përdorimit të Frekuencave, përkundrejt aplikimit të të interesuarit (Aplikanti), pa diskriminim, në mënyrë transparente dhe objektive.
2. Për të garantuar transparencën, objektivitetin dhe barazinë, procedura e aplikimit për Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave, bëhet duke plotësuar nga aplikanti/kërkuesi Modulën e Aplikimit Online për Autorizim Individual, me format përkatëse të publikuar në faqen elektronike të AKEP web: [www.aplikimeonline.al](http://www.aplikimeonline.al).
3. Modelet e Formave të Aplikimit (Moduli i Aplikimit Online) për pajisjen me Autorizim Individual për përdorim të frekuencave, përcaktohen në Aneksat 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje. Përmbajtja e tyre plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 67 të ligjit nr. 9918, te ndryshuar.
4. AKEP-i nëpërmjet strukturës përgjegjëse verifikon përputhshmërinë e kërkesës sipas aplikimit, me Planin Kombëtar dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave, dhe në rast të pasaktësive njofton aplikantin për korrigjimin e tyre.  
Aplikimi është i pranueshëm vetëm kur përmbajtja e tij është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore të transpozuar në këtë rregullore. Data e pranimit nga AKEP-i të aplikimit të rregullt dhe të plotë shënohet automatikisht në modulën e aplikimit online sëbashku me numrin referues të aplikimit. Struktura përgjegjëse printon aplikimin e pranuar dhe e paraqet jo më vonë se në fillim të çdo dite pasardhëse pune, në zyrën e protokoll – Arkivit për regjistrim sipas procedurës.
5. Kur Forma e Aplikimit është e plotësuar rregullisht dhe frekuenca/at e kërkuara janë në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në pikën 4 të nenit 67 të ligjit nr. 9918, te ndryshuar dhe nuk gjendet në kushtet e refuzimit të dhënies së Autorizimit Individual sipas pikës 7 të nenit 67 të po këtij ligji, struktura përgjegjëse i dërgon Sektorit të Financës të dhënat për llogaritjen e pagesave për caktimin dhe përdorimin e frekuencave sipas legjislacionit në fuqi.

Sektorit të Financës, llogarit pagesat për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, nxjerr faturën përkatëse dhe njofton aplikantin për kryerjen e tyre.

Për frekuencat që kërkojnë koordinim ndërkuftar, si dhe frekuencat për shërbime satelitore që kërkojnë marrëveshje ose koordinim ndërshtetëror etj., do të ndiqen procedurat e përcaktuara në Radio Rregulloret e ITU dhe aktet nderkombetare te nenshkruara nga Republika e Shqiperise..

Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas njoftimit të AKEP-it, aplikanti duhet të kryejë pagesën për përdorimin e frekuencave. Me konfirmimin e pagesës aplikantit i lind e drejta e tërheqjes së Autorizimit Individual, të nënshkruar nga Kryetari, duke nënshkruar kopjet e printuara të Formave të aplikimit.

6. Afati i përpunimit të një aplikimi dhe dhënia e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave sipas kësaj rregulloreje, është 30 (tridhjetë) ditë nga data e pranimit të aplikimit të rregullt ( njoftuar aplikantit nga AKEP-i si i tillë).

Autorizimi Individual hartohet në gjuhën Shqipe në dy ekzemplarë origjinalë. Ekzemplari i parë i shtypur në letër A4 me ngjyrë dhe logon e AKEP, i jepet të Autorizuarit dhe ekzemplari i dytë shtypur në letër A4 të zakonshme, mbahet në AKEP i nënshkruar nga i Autorizuari. Në Autorizimin Individual pasqyrohen numri dhe data përkatëse të gjeneruara nga Moduli i aplikimit.

7. Modeli i Autorizimit Individual për përdorim të frekuencave përcaktohet në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje. Modelet, format për caktim dhe përdorim të frekuencave përcaktohen në Aneksin 2/1, 3/1, 4/1, 5/1, 6/1, 7/1 dhe 8/1 të kësaj rregulloreje.
8. Në rastet e kufizimit, sipas pikës 2 të nenit 65 të ligjit 9918, të ndryshuar për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave AKEP-i përdor procedurën e konkurrimit publik, në përputhje me aktet nenligjore në zbatim të tij. Fituesi pajiset nga AKEP-i me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave.
9. AKEP administron Regjistrin e Autorizimeve, për sipërmarrësit apo subjektet e pajisur me Autorizim individual për përdorimin e frekuencave, së bashku me historikun e veprimeve, me anën e një baze të dhënash (database) të aksesueshme për të mundësuar aksesin në distancë.

## **Neni 5**

### **Kushtet e Autorizimit Individual**

1. Aplikanti që pajiset me Autorizim Individual, është i detyruar të përdorë frekuencat sipas përcaktimeve në aneksin/et përkatës të autorizimit individual, kushtet, specifikimet teknike për përdorimin e frekuencave të vendosura në aneksin/aneksin e autorizimit individual apo aktet rregullatorë të nxjerra nga AKEP për këtë qëllim.
2. Sipërmarrësi që operon me Autorizim Individual duhet të zbatojë me shpenzimet e tij ndryshimet e mundshme në frekuencat e caktuara në Autorizimin Individual, kur ato janë pasojë e ndryshimeve të Planit Kombëtar të Radiofrekuencave dhe/ose si rrjedhojë e një vendimi të AKEP për shkak të ushtrimit të kompetencave që burojnë nga Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
3. Sipërmarrësi që operon me Autorizim Individual duhet të shfrytëzojë e mirëmbajë rrjetin e tij të radiokomunikimit në mënyrë të tillë që të mos u shkaktojë shqetësime/interferenca të dëmshme rrjeteve dhe përdoruesve të tjerë të frekuencave.
4. Kur sipërmarrësi që operon me Autorizim Individual konstaton shqetësime në rrjetin e tij të radiokomunikimit, ai mund të kërkojë ndërhyrjen e AKEP. Në rastet e shqetësimeve që kalojnë kufijtë shtetërore, apo me burim nga jashtë kufijve shtetërore, sipërmarrësi që operon me Autorizim Individual duhet t'i japë AKEP, mbështetjen e nevojshme gjatë negociimeve me strukturat përkatëse të vendeve të tjera.

5. Modeli i kërkesës të sipërmarrësit për shqetësime/interferenca të dëmshme të rrjeteve dhe përdoruesve të tjerë të frekuencave në rrjetin e tij valor përcaktohet në Aneksin 9 të kësaj rregulloreje. Ky model plotësohet në Modulën e Aplikimit online.
6. Çdo sipërmarrës që operon me Autorizim Individual, është i detyruar të bashkëpunojë me AKEP-in, kurdo që i kërkohet sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9918, të ndryshuar, kësaj Rregulloreje dhe dispozitave të tjera në fuqi. Ndër të tjera, bashkëpunimi duhet të sigurojë mbështetjen për AKEP në ushtrimin e detyrimeve ligjore, për kontrollin e zbatimit të kushteve dhe termave të kësaj Rregulloreje.
7. Çdo sipërmarrës që operon me Autorizim Individual, çdo muaj dhjetor të vitit në vijim duhet ti konfirmojë AKEP-it, përdorimin e frekuencave të përfshira në Autorizimin Individual, për vitin pasardhës.

## **Neni 6**

### **Vlefshmëria e Autorizimit Individual**

1. Kohëzgjatja e Autorizimit Individual përcaktohet nga AKEP, në zbatim të nenit 72 të Ligjit Nr. 9918, të ndryshuar dhe specifikohet në Autorizim. Kohëzgjatja nuk do të jetë më e madhe se 15 vjet.
2. Në rastin kur Autorizimi Individual do të jepet për shërbime të lëvizshme, ajrore dhe detare, kohëzgjatja e tij do të jepet deri në ndërprerjen e shërbimeve por jo më shumë se 15 vjet.
3. Kohëzgjatja e Autorizimit Individual, në rastet kur frekuencat kërkohet të përdoren për qëllime kërkimi, matjeje dhe prove të pajisjeve të komunikimit për një zonë të kufizuar mbulimi, do të jetë jo më e madhe se 90 dite.
4. Zgjatja e vlefshmërisë së Autorizimit Individual nga AKEP bëhet me kërkesë të mbajtësit të Autorizimit Individual, vetëm në rast se në përfundim të këtij afati, janë përmbushur të gjitha kushtet e përdorimit të frekuencave të caktuara.
5. Aplikimet për zgjatjen e vlefshmërisë së autorizimit të frekuencave bëhen jo më pak se 30 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë përpara përfundimit të vlefshmërisë së tij.
6. Në rast shtyrjeje, AKEP-i lëshon një autorizim të ri të përdorimit të frekuencave me kohëzgjatje në përputhje me legjislacionin në fuqi në momentin e shtyrjes.
7. Vlefshmëria e autorizimeve të përdorimit të frekuencave, të cilat lëshohen për qëllime kërkimi, matjeje dhe për vënie në provë të pajisjeve të radiokomunikimit, si dhe për ngjarje të veçanta, mund të mos zgjaten.

## **KREU III**

### **TRANSFERIMI, NDRYSHIMI DHE REVOKIMI**

## **Neni 7**

### **Transferimi i Autorizimit Individual**



1. Transferimi i të drejtës për përdorimin e frekuencave, bëhet vetëm me miratim nga AKEP, pas kërkesës me shkrim nga mbajtësi i autorizuar, dhe vetëm nëse sipërmarrësi të cilit kërkohet ti kalohet e drejta e përdorimit të frekuencave përmbush kërkesat e ligjit nr. 9918, i ndryshuar dhe rregullat përkatëse, të zbatueshme nga AKEP-i, si edhe që, nga transferimi i kërkuar, nuk krijohen deformime në konkurrencë dhe nuk dëmtohet përdorimi i rregullt, i sigurt dhe eficient i spektrit të frekuencave.
2. Sipërmarrësit që kërkon transferimin e të drejtës për përdorimin e frekuencave tek një sipërmarrës tjetër, nëse AKEP pranon transferimin, i hiqen të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Autorizimit Individual me të cilin ishte pajisur dhe i kalojnë të Autorizuarit të ri.
  - a) Transferimi i të drejtës për përdorimin e frekuencave, do të bëhet nga AKEP, vetëm nëse janë shlyer pagesat përkatëse nga i autorizuari (mbajtës i Autorizimit Individual) deri në momentin që kërkon transferimin.
  - b) Detyrimet për pagesat kalojnë mbi të autorizuarin e ri që nga momenti i transferimit të së drejtës për përdorimin e frekuencave.
  - c) Në rast transferimi të së drejtës për përdorimin e frekuencave nga një i Autorizuar tek një sipërmarrës tjetër, AKEP pajis sipërmarrësin e ri me Autorizim Individual dhe çrregjistron sipërmarrësin e mëparshëm nga regjistrat e tij.
3. AKEP jep miratimin paraprak për transaksione të pritshme në tregun e komunikimeve elektronike dhe për kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP si në Autorizimet e Pergjithshme dhe ato Individuale.
4. Në rast ndryshimi të emrit të sipërmarrësit dhe/ose pronarëve të tij, ky fakt i bëhet me dije me shkrim AKEP në zbatim të detyrimeve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9918 për ndryshimet në Njoftimin e Autorizimit të Pergjithshëm, por jo më vonë se 30 ditë dhe shoqërohet me dokumentacionin përkatës që vërteton ndryshimin. AKEP brenda 30 ditëve kryen ndryshimet në Autorizimin e mëparshëm dhe e ripajis sipërmarrësin me Autorizim Individual. Në këtë rast, koha e vlefshmërisë së Autorizimit Individual nuk ndryshon.
5. Pas miratimit paraprak të AKEP, sipërmarrësi tek i cili do të kalojnë të drejtat dhe detyrimet e transferuara të autorizimit individual, aplikon në AKEP sipas procedurës të percaktuar në nenin 4 të kësaj rregulloreje.

## **Neni 8**

### **Ndryshimet në autorizimin individual**

1. AKEP-i mund të ndryshojë autorizimin individual me nismën e vet:
  - a) Nëse pëson ndryshime Plani Kombëtar i Frekuencave,
  - b) Nëse pëson ndryshime Plani i Përdorimit të Frekuencave,
  - c) Nëse pësojnë ndryshime rregullat për kushtet e përdorimit të frekuencave;
  - ç) Për nevoja publike, që nuk mund të plotësohen në mënyrë tjetër;
  - d) Kur kërkohet të rritet efienca e përdorimit të frekuencave,
  - e) Kur ndryshimi është me interes publik;
  - f) Për shmangien e interferencave të dëmshme kur nuk mund të shmangen në mënyrë tjetër;
  - g) Në zbatim të akteve ndërkombëtare, të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

2. Në rastet e parashikuara në pikën 1 të mësipërme, AKEP-i lëshon një autorizim individual të ri të përdorimit të frekuencave, i cili përfshin ndryshimet. Në autorizimin e ri AKEP cakton një periudhë të arsyeshme kohe, brenda së cilës mbajtësi i autorizimit duhet të përshtasë përdorimin e frekuencave me autorizimin e ri,
3. Në rast të ndryshimit të autorizimit individual nga AKEP, mbajtësi i autorizimit individual përballon me shpenzimet e veta kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme në perputhje me kushtet e autorizimit të ri.
4. Në rast se arsyet për ndryshimin ose revokimin e autorizimit nuk shkaktohen për fajin e të autorizuarit, mund t'i caktohet brez tjetër ekuivalent i frekuencave brenda hapësirave të mundshme, sipas planit të përdorimit të frekuencave.
5. Në rast se ndryshimet në autorizimin individual të frekuencave kërkojnë nga mbajtësi i tij, AKEP lëshon një autorizim të ri mbi bazën e aplikimit nga sipermarresi konform kesaj rregulloreje.

## **Neni 9**

### **Revokimi i Autorizimit Individual**

1. Autorizimi Individual është një akt administrativ i revokueshëm sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr.9918, të ndryshuar dhe Kodin e Procedurave Administrative.
2. Autorizimi Individual mund të revokohet me kërkesën e sipërmarrësit në emër të cilit është lëshuar (mbajtësit) ose me nismën e AKEP-it.
3. Autorizim Individual revokohet me nismën e organit që e ka nxjerrë atë, kur vërtetohet se:
  - a) Aplikimi për autorizim për frekuenca përmban të dhëna të rreme;
  - b) I autorizuari ka shkelur dispozitat e ligjit 9918, të ndryshuar;
  - c) I autorizuari nuk ka zbatuar kushtet e autorizimit individual;
  - ç) I autorizuari ka transferuar të drejtën e përdorimit të frekuencave sipërmarrësve të tjerë pa miratimin e AKEP.
  - d) I autorizuari nuk i ka përdorur frekuencat e dhëna brenda një viti nga data e dhënies në përdorim. I autorizuari nuk mban përgjegjësi për mosplotësimin e kushteve të Autorizimit Individual, vetëm për shkaqe që rrjedhin në rast ndodhje të ndonjë Force Majeure.
  - e) I autorizuari nuk ka zbatuar urdhërat e AKEP për të eliminuar mangësitë e konstatuara nga AKEP, brenda afatit të përcaktuar.
  - f) I autorizuari nuk ka kryer pagesat për përdorimin e frekuencave brenda 30 ditëve nga afati i përcaktuar ose 15 ditë pas njoftimit nga AKEP.
  - g) AKEP nuk ka mundësi të tjera për të shmangur interferencat e dëmshme.
4. Me kërkesën e mbajtësit, Autorizimin Individual revokohet nga organi i AKEP-it që e ka nxjerrë atë, kur:

- a) Kërkesa për revokim është e motivuar dhe bazuar ligjërisht;
5. Pas aktit revokues të Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave, sipërmarresi apo subjekti regjistrohet nga Regjistri i Autorizimeve.

**Neni 10**  
**Përfundimi i vlefshmërisë së autorizimit individual**

1. Vlefshmëria e autorizimit individual përfundon:
  - a) me mbarimin e afatit kohor të përcaktuar në autorizim;
  - b) në rast se mbajtësi i autorizimit nuk ekziston më;
  - c) kur mbajtësi i autorizuar heq dorë nga autorizimi individual.
2. Pagesat e kryera për vitin kur përfundon autorizimi individual, nuk janë të rimbursueshme.

**Neni 11**  
**Pagesat për përdorimin e frekuencave**

Për caktimin dhe përdorimin e frekuencave bëhet pagesa sipas ligjeve në fuqi, VKM përkatëse dhe rregullave të AKEP.

**Neni 12**  
**Ankesat**

1. Ankesat e mundshme të aplikantëve ndaj:
  - a. refuzimit të pranimit të një aplikimi për Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave;
  - b. procedurës së zbatuar nga struktura përgjegjëse e AKEP-it për trajtimin e aplikimit,paraqiten në AKEP jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e marrjes së njoftimit të mospranimit ose të përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 7 të nenit 4 të kësaj rregulloreje, dhe shqyrtohen nga Këshilli Drejtues i tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e pranimit të ankimit.
2. Ankesat e mundshme ndaj një akti revokues të AKEP-it sipas nenit 76 të ligjit nr. 9918, të ndryshuar, për autorizimin individual, paraqiten nga sipërmarrësi në AKEP brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të aktit revokues, dhe shqyrtohen nga Këshilli Drejtues i AKEP-it, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e pranimit të ankimit.
3. Forma dhe përmbajtja e ankimit bëhet në përputhje me përcaktimet e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë.
4. Vendimet e shqyrtimit të ankimeve nga Këshilli Drejtues i AKEP-it, janë të ankimeshme në rrugë gjyqësore sipas përcaktimeve të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe Kodin e Procedurës Civile, të fuqi në momentin e nxjerrjes së vendimit.

**KREU IV**  
**DISPOZITA TË FUNDIT DHE TRANZITORE**

**Neni 13**  
**Shfuqizimi**

Rregullorja “Për Autorizimin Individual”, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave miratuar me Vendimin Nr. 510, datë 04.11.2008 të Këshillit Drejtues të AKEP, shfuqizohet.

**Neni 14**  
**Hyrja në Fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të Këshillit Drejtues të AKEP-it..



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

---

**AUTORIZIM INDIVIDUAL**

Nr. \_\_\_\_ / \_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . \_\_\_\_

**SIPERMARRESI:**

“ \_\_\_\_\_ ”

**KRYETARI**

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi & vula e autoritetit)



## ANEKS N° 2/1

### PER CAKTIM DHE PERDORIM FREKUENCASH NE BREZAT VHF, UHF. SISTEME RADIOKOMUNIKIMI.

Te dhenat e Sipermarresit	
Emri i Personit Fizik/Juridik	
Adresa Postare	
Qyteti / Shteti	
Kutia Postare	
NIPT-i	
Data e Regjistrimit ne QKR	/ /
Telefon	
Fax	
E-Mail	
Personi i Kontaktit	
Telefon	
Fax	
E-Mail	

Vendndodhja dhe Zona e mbulimit						
Stacioni Baze						
Vendi i Instalimit						
Koordinatat Gjeografike [grade]	°N:	Min:	Sec:	°E:	Min:	Sec:
Lartësia nga Niveli i detit [m]						
Stacioni Perserites						
Vendi i Instalimit						
Koordinatat Gjeografike [grade]	°N:	Min:	Sec:	°E:	Min:	Sec:
Lartësia nga Niveli i detit [m]						
Zona ku ofrohet sherbimi	1.				2.	
	3.				4.	

Te dhenat e Frekuencave			
Lloji i Operimit te sistemit PMR			
Lloji i Sherbimit			
Brezi i Frekuencave [MHz]			
Gjeresia e Kanalit [kHz]			
Frekuencat e Caktuara [MHz]	<i>Stacioni Baze:</i>	.	<i>Gjeresi Kanali:</i> [kHz]
	<i>Stacioni Perserites:</i>	.	<i>Gjeresi Kanali:</i> [kHz]
	<i>Stacioni ne Makine:</i>	.	<i>Gjeresi Kanali:</i> [kHz]
	<i>Radio Portative</i>	.	<i>Gjeresi Kanali:</i> [kHz]



### Te dhenat e Pajisjes Radio

Stacioni Baze	Prodhuesi:	Tipi (Modeli):
	Fuqia per tek antena [dBW]:	.
Stacioni Perserites	Prodhuesi:	Tipi (Modeli):
	Fuqia per tek antena [dBW]:	.
Stacioni ne Makine	Prodhuesi:	Tipi (Modeli):
	Fuqia per tek antena [dBW]:	.

### Te dhenat e Antenes

Stacioni Baze	Prodhuesi:	Tipi (Modeli):
	Lartesia mbi nivelin e tokes:	
	Polarizimi:	Azimuthi [°]:
	Perforcimi maksimal [dBi]:	
Stacioni Perserites	Prodhuesi:	Tipi (Modeli):
	Lartesia mbi nivelin e tokes:	
	Polarizimi:	Azimuthi [°]:
	Perforcimi maksimal [dBi]:	
Stacioni ne Makine	Prodhuesi:	Tipi (Modeli):
	Lartesia mbi nivelin e tokes:	
	Polarizimi:	Azimuthi [°]:
	Perforcimi maksimal [dBi]:	

### Afati i perdorimit te Frekuencave

Koha e perdorimit te frekuencave te caktuara nga AKEP:      Fillon    /    /                      Mbaron    /    /

Sipas aplikimit me numër reference: \_\_\_\_\_

**K R Y E T A R I**

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi & vula e autoritetit)



## ANEKS N° 3/1

### PER CAKTIM DHE PERDORIM FREKUENCASH NE BREZAT VHF, UHF. SISTEME RADIOALARMI.

Te dhenat e sipermarresit	
Emri i Personit Fizik/Juridik	
Adresa Postare	
Qyteti / Shteti	
Kutia Postare	
NIPT-i	
Data e Regjistrimit ne QKR	/ /
Telefon	
Fax	
E-Mail	
Personi i Kontaktit	
Telefon	
Fax	
E-Mail	

Vendndodhja dhe zona e mbulimit						
Stacioni Baze						
Vendi i Instalimit						
Koordinatat Gjeografike [grade]	°N:	Min:	Sec:	°E:	Min:	Sec:
Lartësia nga Niveli i detit [m]						
Stacioni Perserites						
Vendi i Instalimit						
Koordinatat Gjeografike [grade]	°N:	Min:	Sec:	°E:	Min:	Sec:
Lartësia nga Niveli i detit [m]						
Zona ku ofrohet sherbimi	1.				2.	
	3.				4.	

Te dhenat e Frekuencave			
Lloji i Operimit te sistemit PMR			
Lloji i Sherbimit			
Brezi i Frekuencave [MHz]			
Gjeresia e Kanalit [kHz]			
Frekuencat e Caktuara [MHz]	<i>Stacioni Baze:</i>	.	<i>Gjeresi Kanali:</i> [kHz]
	<i>Stacioni Perserites:</i>	.	<i>Gjeresi Kanali:</i> [kHz]
	<i>Stacionet periferike:</i>	.	<i>Gjeresi Kanali:</i> [kHz]



**A K E P**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Te dhenat e pajisjes radio		
Stacioni Baze	Prodhuesi:	Tipi (Modeli):
	Fuqia per tek antena [dBW]:	.
Stacioni Perserites	Prodhuesi:	Tipi (Modeli):
	Fuqia per tek antena [dBW]:	.
Stacionet Periferike	Prodhuesi:	Tipi (Modeli):
	Fuqia per tek antena [dBW]:	.

Te dhenat e antenes		
Stacioni Baze	Prodhuesi:	Tipi (Modeli):
	Lartesia mbi nivelin e tokes:	
	Polarizimi:	Azimuthi [°]:
	Perforcimi maksimal [dBi]:	
Stacioni Perserites	Prodhuesi:	Tipi (Modeli):
	Lartesia mbi nivelin e tokes:	
	Polarizimi:	Azimuthi [°]:
	Perforcimi maksimal [dBi]:	
Stacionet Periferike	Prodhuesi:	Tipi (Modeli):
	Lartesia mbi nivelin e tokes:	
	Polarizimi:	Azimuthi [°]:
	Perforcimi maksimal [dBi]:	

**Afati i perdorimit te Frekuencave**

Koha e perdorimit te frekuencave te caktuara nga AKEP:      Fillon    /    /                      Mbaron    /    /

Sipas aplikimit me numër reference: \_\_\_\_\_

**K R Y E T A R I**\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi & vula e autoritetit)

**A K E P**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**ANEKS N° 4/1****PER CAKTIM DHE PERDORIM FREKUENCASH PER LIDHJE FIKSE.  
SISTEME PIKE-PIKE.**

<b>Te dhenat e Sipermarresit</b>	
Emri i Personit Fizik/Juridik	
Adresa Postare	
Qyteti / Shteti	
Kutia Postare	
NIPT-i	
Data e Regjistrimit ne QKR	/ /
Telefon	
Fax	
E-Mail	
Personi i Kontaktit	
Telefon	
Fax	
E-Mail	

<b>Te dhenat e Frekuencave</b>			
Brezi i Frekuencave [GHz]			
Gjeresia e Kanalit [kHz]	.		
Frekuencat e Caktuara [MHz]	Stacioni A:	.	Gjeresi Kanali: [kHz]
	Stacioni B:	.	Gjeresi Kanali: [kHz]

<b>Vendndodhja dhe Zona e mbulimit</b>						
Stacioni A						
Vendi i Instalimit						
Koordinatat Gjeografike [grade]	°N:	Min:	Sec:	°E:	Min:	Sec:
Lartësia nga Niveli i detit [m]						
Stacioni B						
Vendi i Instalimit						
Koordinatat Gjeografike [grade]	°N:	Min:	Sec:	°E:	Min:	Sec:
Lartësia nga Niveli i detit [m]						
Distanca midis Stacionit A dhe B [km]						

**A K E P**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**Te dhenat e Pajisjes Radio**

	Stacioni A	Stacioni B
Prodhuesi:		
Tipi (Modeli):		
Tipi i Modulimit		
Emisioni:		
Gjerësia e kanalit [MHz]	.	.
Kapaciteti i Transmetimit [Mbit/s]		
Ndjeshmeria ( $BER 10^{-6}$ ) [dBm]	.	.
Fuqia ne dalje e transmetuesit [dBm]	.	.
Fuqia per tek antena [dBW]	.	.
Humbjet ne fider per gjatesi 100 [dB]		

**Te dhenat e Antenes**

	Stacioni A	Stacioni B
Prodhuesi:		
Tipi (Modeli):		
Lartësia mbi nivelin e tokës (AGL) [m]		
Polarizimi (V/H)		
Perforcimi Max. [dBi]		
Kendi i Lartësimit / Azimuti	° / °	° / °

**Afati i perdorimit te Frekuencave**

Koha e perdorimit te frekuencave te caktuara nga AKEP:      Fillon    /    /                      Mbaron    /    /

Sipas aplikimit me numër reference: \_\_\_\_\_

**K R Y E T A R I**\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi & vula e autoritetit)

**A K E P**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**ANEKS N° 5/1****PER CAKTIM DHE PERDORIM FREKUENCASH PER STACION  
SATELITOR**

<b>Te dhenat e Sipermarresit</b>	
Emri i Personit Fizik/Juridik	
Adresa Postare	
Qyteti / Shteti	
Kutia Postare	
NIPT-i	
Data e Regjistrimit ne QKR	/ /
Telefon	
Fax	
E-Mail	
Personi i Kontaktit	
Telefon	
Fax	
E-Mail	

<b>Vendndodhja</b>						
Stacioni Satelitor Tokesor:						
Vendi i Instalimit						
Koordinatat Gjeografike [grade]	°N:	Min:	Sec:	°E:	Min:	Sec:
Lartësia nga Niveli i detit [m]						
Kendi Azimutal i Operimit	Nga	°	ne	°	Kendi i Lartesimit:	°
Terminali:						
Vendi i Instalimit						
Koordinatat Gjeografike [grade]	°N:	Min:	Sec:	°E:	Min:	Sec:
Lartësia nga Niveli i detit [m]						
Kendi Azimutal i Operimit	Nga	°	ne	°	Kendi i Lartesimit:	°
Emri i Stacionit Hapsinor (Emertimi sipas ITU-se)						
Pozicioni Orbital Nominal	Grade				E/W	

<b>Karakteristikat te Stacionit Tokesor Satelitor</b>		
Prodhuesi:		
Tipi (Modeli):		
Fuqia Max. Agregate [dBW]	.	Modulimi:
Brezi i frekuencave [GHz]		
Frekuenat e Punes [GHz]	Tx: .	Rx: .
Gjeresia e Brezit	Uplink: . kHz	Downlink: . MHz
Kapaciteti i Transmetimit	Uplink: . Kbit/s	Downlink: . Mbit/s

**A K E P**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

<b>Karakteristikat e Terminalit</b>		
Prodhuesi		
Tipi (Modeli)		
Fuqia Max. Agregate [dBW]	.	<b>Modulimi:</b>
Brezi i frekuencave [GHz]		
Frekencat e Punes [GHz]	Tx: .	Rx: .
Gjeresia e Brezit	Uplink: . kHz	Downlink: . MHz
Kapaciteti i Transmetimit	Uplink: . Kbit/s	Downlink: . Mbit/s

<b>Te dhenat e Antenes</b>		
	Stacioni Tokesor Satelitor	Terminali
Prodhuesi		
Tipi (Modeli)		
Lartesia mbi nivelin e tokes (AGL) [m]		
Diametri		
Polarizimi		
Perforcimi Max. Isotropik [dBi]		
Beamwidth	0	0

### **Afati i perdorimit te Frekuencave**

Koha e perdorimit te frekuencave te caktuara nga AKEP:      Fillon    /    /                      Mbaron    /    /

Sipas aplikimit me numër reference: \_\_\_\_\_

**K R Y E T A R I**

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi & vula e autoritetit)



## ANEKS N° 6/1

### PER CAKTIM DHE PERDORIM FREKUENCASH PER SISTEME TETRA

Te dhenat e sipermarresit	
Emri i Personit Fizik/Juridik	
Adresa Postare	
Qyteti / Shteti	
Kutia Postare	
NIPT-i	
Data e Regjistrimit ne QKR	/ /
Telefon	
Fax	
E-Mail	
Personi i Kontaktit	
Telefon	
Fax	
E-Mail	

Vendndodhja dhe zona e mbulimit								
Stacioni Baze								
Vendi i Instalimit								
Koordinatat Gjeografike [grade]	°N:	Min:	Sec:	°E:	Min:	Sec:		
Lartësia nga Niveli i detit [m]								
Koordinat gjeografike te pikave kufitare te zones se sherbimit:	1.	N	,	E	2.	N	,	E
	3.	N	,	E	4.	N	,	E
	5.	N	,	E	6.	N	,	E

Te dhenat e Frekuencave			
Lloji i Sherbimit			
Brezi i Frekuencave [MHz]			
Gjeresia e Kanalit [kHz]			
Frekuencat e Caktuara [MHz]	<i>Stacioni Baze:</i>	.	<i>Gjeresi Kanali:</i> [kHz]
		.	<i>Gjeresi Kanali:</i> [kHz]
		.	<i>Gjeresi Kanali:</i> [kHz]

Te dhenat e pajisjes radio	
Stacioni Baze	Prodhuesi: . . . . . Tipi (Modeli):
	Fuqia per tek antena [dBW]: . . . . .

#### Te dhenat e antenes

**A K E P**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Stacioni Baze	Prodhuesi:	Tipi (Modeli):
	Lartesia mbi nivelin e tokes:	
	Polarizimi:	Azimuthi [°]:
	Perforcimi maksimal [dBi]:	

**Afati i perdorimit te Frekuencave**

Koha e perdorimit te frekuencave te caktuara nga AKEP:      Fillon    /    /                      Mbaron    /    /

Sipas aplikimit me numër reference: \_\_\_\_\_

**K R Y E T A R I**\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi & vula e autoritetit)



## ANEKS N° 7/1

### PER CAKTIM DHE PERDORIM FREKUENCASH PER LIDHJE FIKSE. BREZI I FREKUENCAVE DERI 1 GHz

#### Te dhenat e Sipermarresit

Emri i Personit Fizik/Juridik	
Adresa Postare	
Qyteti / Shteti	
Kutia Postare	
NIPT-i	
Data e Regjistrimit ne QKR	/ /
Telefon	
Fax	
E-Mail	
Personi i Kontaktit	
Telefon	
Fax	
E-Mail	

#### Te dhenat e Frekuencave

Lloji i Operimit te sistemit PMR	
Lloji i Sherbimit	
Brezi i Frekuencave [GHz]	
Gjeresia e Kanalit [kHz]	.
Frekuencat e Caktuara [MHz]	<i>Stacioni A:</i> . <i>Gjeresi Kanali:</i> [kHz]
	<i>Stacioni B:</i> . <i>Gjeresi Kanali:</i> [kHz]

#### Vendndodhja dhe Zona e mbulimit

Stacioni A	
Vendi i Instalimit	
Koordinatat Gjeografike [grade]	°N: Min: Sec: °E: Min: Sec:
Lartësia nga Niveli i detit [m]	
Stacioni B	
Vendi i Instalimit	
Koordinatat Gjeografike [grade]	°N: Min: Sec: °E: Min: Sec:
Lartësia nga Niveli i detit [m]	
Distanca midis Stacionit A dhe B [km]	





Te dhenat e Pajisjes Radio		
	Stacioni A	Stacioni B
Prodhuesi:		
Tipi (Modeli):		
Tipi i Modulimit		
Emisioni:		
Gjeresia e kanalit [MHz]	.	.
Kapaciteti i Transmetimit [Mbit/s]		
Ndjeshmeria ( $BER 10^{-6}$ ) [dBm]	.	.
Fuqia ne dalje e transmetuesit [dBm]	.	.
Fuqia per tek antena [dBW]	.	.
Humbjet ne fider per gjatesi 100 [dB]		

Te dhenat e Antenes		
	Stacioni A	Stacioni B
Prodhuesi:		
Tipi (Modeli):		
Lartesia mbi nivelin e tokes (AGL) [m]		
Polarizimi (V/H)		
Perforcimi Max. [dBi]		
Kendi i Lartesimit / Azimuti	0 / 0	0 / 0

### Afati i perdorimit te Frekuencave

Koha e perdorimit te frekuencave te caktuara nga AKEP:      Fillon    /    /                      Mbaron    /    /

Sipas aplikimit me numër reference: \_\_\_\_\_

**KRYETARI**

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi & vula e autoritetit)



## ANEKS N° 8/1

### PER CAKTIM DHE PERDORIM FREKUENCASH PER STUDIM, KERKIM, PROVE DHE EKSPERIMENTIM

Te dhenat e Sipermarresit	
Emri i Personit Fizik/Juridik	
Adresa Postare	
Qyteti / Shteti	
Kutia Postare	
NIPT-i	
Data e Regjistrimit ne QKR	/ /
Telefon	
Fax	
E-Mail	
Personi i Kontaktit	
Telefon	
Fax	
E-Mail	

Te dhenat e Aktivitetit	
Qellimi I aktivitetit	
Nr. I pjesemaresve ne aktivitet	.
Koha kur do te zhvillohet aktiviteti	
Numeri i stacioneve fikse gjate aktivitetit.	

Vendndodhja e Stacionit Fiks						
Vendi i Instalimit						
Koordinatat Gjeografike [grade]	°N:	Min:	Sec:	°E:	Min:	Sec:
Lartësia nga Niveli i detit [m]						

Te dhenat e Frekuencave			
Brezi i Frekuencave [GHz]			
Gjeresia e Kanalit [kHz]	.		
Frekuencat e Caktuara [MHz]	<i>Stacioni Fiks:</i>	.	<i>Gjeresi Kanali:</i> [kHz]
		.	<i>Gjeresi Kanali:</i> [kHz]



### Te dhenat e Pajisjes Radio

Prodhuesi:	
Tipi (Modeli):	
Gjerësia e kanalit [MHz]	.
Ndeshmeria ( $BER 10^{-6}$ ) [dBm]	.
Fuqia ne dalje e transmetuesit [dBm]	.
Fuqia Max. per tek antena [dBW]	.
Fuqia Min. per tek antena [dBW]	.

### Te dhenat e Antenes

Prodhuesi:	
Tipi (Modeli):	
Lartësia mbi nivelin e tokës (AGL) [m]	
Polarizimi (V/H)	
Perforcimi Max. [dBi]	
Kendi i Lartësimit / Azimuti	° / °

### Afati i perdorimit te Frekuencave

Koha e perdorimit te frekuencave te caktuara nga AKEP:      Fillon    /    /                      Mbaron    /    /

Sipas aplikimit me numër reference: \_\_\_\_\_

**KRYETARI**

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi & vula e autoritetit)